

RAPORT VJETOR

2021



PËRMBAJTJA

Rreth Insig Jetë	3
Perberja e Kapitalit dhe Drejtimi I Shoqerise	4
Misioni dhe Vizioni	6
Vlerat Tona	7
Tregues te aktivitetit 2021	8
Strategjia 2021 dhe implementimi	9
Raporti vjetor i Auditit te Brendshem	10
Raporti i Audituesit të pavarur	15
Pasqyrat Financiare	17

Rreth INSIG Jete

- Krijuar ne Janar 2017. nga ndarja e aktivitetit te INSIG sh.a ne Jete dhe Jojete, INSIG Jete, trashgoi me vete historine dhe zhvilloi eksperiencen shume vjecare te INSIG-ut, duke e fuqizuar dhe pershtatur ate me nevojat dhe sfidat e zhvillimit te tregut te sigurimeve ne pergjithesi dhe atij te Jetes ne vecanti, por sidomos duke fituar sfiden e kalimit nga nje kompani me kapital dhe mentalitet shteteror ne nje kompani me sjellje dhe qasje private.
- INSIG Jete, ushtron aktivitetin e saj sigurues, ne pershtatshmeri dhe perputhje me kriteret e legjislacionit Shqiptar per Sigurimet dhe Risigurimet, sipas licences Nr 4/2000 date 27/12/2016, aprovuar nga Autoriteti I Mbikqyrjes Financiare.
- E paisur me NUIS: L71325020H, INSIG Jete ka te drejten te ushtroje veprimtarine e saj siguruese ne te tera klasat e Sigurimit te Jetes qe njeh ligji Shqiptar i sigurimeve.
- Gjate ketij viti te veshtire e kompleks te ndikuar nga pandemia boterore, Impenjimi ynë kryesor ka qene ruajtja e strukturave operative per funksionimin operacional te shoqerise si edhe i situates financiare te shendetshme.
- Përmbushja sa më mirë e nevojave dhe kërkesave te klienteve, duke projektuar dhe përmirësuar oferten tonë, duke përfshirë zgjidhje për cdo rast të dedikuar, ka qene synimi dhe fokusi yne gjate ketij viti, duke shpresuar qe me sherbimin tone, te kemi ndikuar sado pak pozitivisht në jetën e klientëve tanë, qofshin keta, individëve, familje apo edhe kompani.



Perberja e kapitalit

Eurosig Group, është aksioneri i vetem i kompanise INSIG Jete, ku me date 31/08/2020 Bordi I AMF , vendosi miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën 100% të aksionarit Shoqëria jo - jetë "EUROSIG" sh.a. në shoqërinë e sigurimit të Jetës “Insig Jetë” sh.a..


Drejtimi i Shoqerise

INSIG Jete sh.a., eshte organizuar dhe funksionon si nje shoqeri tregtare me dy nivele drejtimi. Organet qeverisese jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve

- Keshilli Mbikqyre
 - Vaso PILO – kryetar
 - Anila IBRO - anetare
 - Forcim KOLA - anetar

- Drejtore Ekzekutive
 - Elvana MINO





Organigrama



Mission & vision

Vizioni

Ngritja e imazhit të një kompanie të re, të përqëndruar në atributet e cilësisë dhe të besimit, që ofron shumëllojshmëri produktesh bashkëkohore sigurimi.

Misioni

Misioni i kompanisë INSIG Jeta sh.a, është të jetë një nga kompanitë udhëheqëse në tregun Shqiptar duke u mbështetur në:

- staf teknik, profesional e me përvojë disa vjeçare në fushën e sigurimeve;
- suportin e kompanive më të njohura në tregun e risigurimeve;
- produkte të standarteve bashkëkohore;
- një politikë të qartë marketingu;
- një sistem dinamik shpërndarjeje me bazë ndarjen gjeografike dhe segmentimin e tregut.

Vlerat tona

- Besueshmeria: Ne ndërtojme raporte besimi në terma afatgjatë me klientët, qofshin këta individë, familje apo kompani.
- Përshtatshmëria: Dimë të paraprijmë dhe të plotësojmë kërkesat, duke personalizuar zgjidhjet optimale në bazë të nevojave të klientëve.
- Aksesueshmëria: Mundohemi te krijojme nje oferte sa me te thjeshte per t'u kuptuar dhe per perdorur. Gjithmonë të disponueshëm dhe me një kosto konkurruese në treg.
- Sherbimi: Sigurojmë arritjen e rezultatit duke performuar ne menyren më të mirë të mundshme.
- Impenjimi: Me disipline dhe integritet, ne japim maksimumin tone, per te mbajtur dhe realizuar premtimet.
- Vleresimi: Ne promovojmë diversitetin dhe investojmë tek punonjësit tanë, duke favorizuar të mësuarit e vazhdueshëm dhe rritjen profesionale per te krijuar një ambjent transparent në punë, bashkëpunues dhe të aksesueshëm nga të gjithë. Rritja e njerëzve tanë garanton të ardhmen e kompanisë tonë në vazhdimësi.



+3%

rritje ne
kapitalet e veta

128 %

mbulim
provigjonesh

+84,3 mil ALL

mjaftueshmeri
Kapitali

15,25 % ne treg

20,2 mil ALL fitimi
i vitit

218 mil ALL Prime
te shkruara Bruto

Tregues mesatar
vjetor i likuidetit
1.2

Numri i degeve:
7 Dege

Primi i vitit:
218 mil ALL

Numri i policave:
129,000

Demet e
paguara ne
total: **88 mil ALL**

Objektivat Strategjike

Për vitin 2021, veprimtaria e strukturave qendrore dhe vendore të INSIG JETË do të orientohet drejt këtyre prioriteteve:

- ❖ Konsolidimi i pozicionit të kompanisë në treg, nëpërmjet cilësisë së lartë të shërbimit dhe ruajtja e imazhit të shoqërisë INSIG JETË në tregun e sigurimeve të aktivitetit jetë;
- ❖ Ruajtja e parametërve financiarë të aftësisë paguese dhe mbulimit të provigjoneve teknike;
- ❖ Ruajtja e një norme fitimi të qëndrueshme dhe rritja e vlerës së aksioneve;
- ❖ Zbatimi i politikave efektive të investimeve financiare me qëllim rritjen e vlerës së tyre;
- ❖ Zbatimi i politikave të qarta dhe efektive për vlerësimin, kontrollin dhe menaxhimin e riskut;
- ❖ Zbatimi dhe forcimi i një sistemi të shpejtë dhe eficient të kontrollit të brendshëm të kompanisë;
- ❖ Zbatimi i saktë dhe korrekt i legjislacionit fiskal dhe sigurues, udhëzimeve dhe rregulloreve të AMF si edhe politikave dhe standardeve kontabel;
- ❖ Përmirësimi i sistemeve teknologjike dhe pershtatja me nevojat në rritje të kompanisë;
- ❖ Ulja e kostove joproduktive dhe rishikimi i politikave të marketingut;
- ❖ Shërbim i shpejtë dhe korrekt i dëmeve duke forcuar edhe kontrollin e kostove të shpenzimeve mjekësore;
- ❖ Bashkëpunim eficient me risiguruesit;
- ❖ Ruajtja dhe konsolidimi i bashkëpunimit me Autoritetin e Mbikqyrjes dhe institucionet e ndryshme të varesisë si edhe me kompanitë konkurente.
- ❖ Ruajtja e nivelit të shitjeve, në sinkronizim me nivelin e tregut të sigurimeve, duke realizuar një rritje me +15% të volumit të primeve të shkruara bruto, krahasuar me vitin 2021.
- ❖ Realizimi i treguesve duke ruajtur një nivel optimal të shpenzimeve të aktivitetit të biznesit
- ❖ Rritja e përfitueshërisë në tërësi të shoqërisë.
- ❖ Trajtim profesional të praktikave të dëmeve, vlerësim të drejtë, pagesë të shpejtë, duke synuar vlerën 33% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumin e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2022.

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

- **Baza ligjore**

Njesia e Auditimit te brendshem gjate vitit 2021 ka zhvilluar veprimtarine e saj mbeshtetur ne ligjet dhe aktet nen/ ligjore te cilat rregullojne Veprimtarine e Shoqerise INSIG Jete sh.a, me qellim arritjen e objektivave ne ushrimin e funksionit te vet.

- Ligji 52 / 2014 “ Per veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit”
- Manuali i Auditimit dhe udhezime te tjera te miratuara nga Ministri i Financave dhe (NJQHAB),
- Standartet Profesionale Kombetare dhe Nderkombetare te Auditimit.
- Rregullore e AMF nr.153 date 23/12/2014, “Per veprimtarine e Njesise Auditimit te Brendshem dhe Komitetit te Auditimit ne Shoqerite e Sigurimit”,
- Statuti i Shoqerise INSIG Jete sha , miratuar me Vendim nr.04 date 08.09.2020,
- Rregullore per Organizimin dhe Funksionimin e Shoqerise INSIG Jete sha,etj.
- Rregullore e funksionimit te brendshem te Komitetit te Auditimit.
- Rregullore per veprimtarine e AB ne Shoqerine e Sigurimeve INSIG Jete sha

- **Organizimi**

Misioni i Auditimit te Brendshem

Gjate vitit 2021, Njesia e Auditimit ka kontrolluar dhe audituar ecurine e punes ne fushat kryesore te veprimtarise Insig Jete sha ne drejtim te shitjes, marrjes ne sigurim, demeve, perputhshmerise, bazes rregullative,finances, IT, pastrimit dhe parandalimit te parase etj.Njesia e auditit te brendshem nen cilesine e nje strukture te posaçme ka kryer funksionet e saj ne menyre te pavarur dhe objektive, duke dhene nje opinion te specializuar ne funksion te permiresimit te veprimtarise shoqerise.Ne perfundim te procesit te auditimit jane dhene rekomandimet perkatese dhe propozime per te permiresuar funksionimin, aty ku eshte e nevojshme.

Funksioni i Auditit te Brendshem

Auditimi i brendshem perveç te tjerash perfshin krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e nje plani auditimi te bazuar ne risk, per te shqyrtuar dhe vleresuar fusha te pergjitheshme apo te veçanta bazuar ne masa parandaluese. Siguron qe risqet e identifikuara dhe veprimet e mara per t’i adresuar jane te sakta dhe aktuale. Kryerjen e vleresimeve te rregullta ne funksion te auditit dhe auditimit te sistemeve te brendshme duke perfshire dhe permiresimet e nevojshme. Siguron qe fushat me risk te jene subjekte te perzgjedhura te auditimit. Auditimi i brendshem per te gjitha fushat dhe çeshtjet e shqyrtuara ka hartuar raporte.

Objektivi i Auditimit te Brendshem

Objektivi i auditit te brendshem konsiston ne kontrollle te thelluara dhe tematike, prane departamnteve dhe degeve perkatese ne kohe dhe me efektivitet per te bere te mundur vleresimin e rreziqeve si dhe te garantoje se:

- Risqet identifikohen dhe menaxhohen ne menyren e duhur.
- Nderveprim midis departamenteve, sektoreve dhe degeve ne rrethe.
- Informacioni financiar, menaxherial dhe operacional eshte i sakte dhe i besueshem ne kohe.
- Kryerja e detyrave nga punonjesit eshte ne pëputhje me politikat, standartet, procedurat dhe ligjet e rregulloret ne fuqi.
- Burimet sigurohen dhe perdoren me evidence.
- Permiresim i vazhdueshem ne procesin e kontrollit te brendshem.
- Çeshtjet e rendesishme legjislative dhe rregullatore, qe kane ndikim ne Shoqerine INSIG JETE sh.a, jane pranuar dhe adresuar siç duhet.

Organizimi i Burimeve Njerezore dhe Finaciare te Auditit te Brendshem

Auditi i brendshem vepron ne zbatim te ligjit nen cilesine e nje strukture te posaçme. Auditi i brendshem eshte punonjes i Shoqerise i emeruar ne Njesine e Auditimit te Brendshem.

Analiza e Veprimtarise Auditit te Brendshem

Ne lidhje me burimet e kontrollit per ushtrimin e veprimtarise gjate vitit 2021, auditimi eshte kryer bazuar ne planin vjetor te miratuar nga Keshilli Mbikeqyres. Kontrolli i ushtruar eshte fokusuar ne analizen e proceseve, risqeve dhe te dhenave te grumbulluara ne dokumentacionin qe shoqeria INSIG JETE sh.a perdor. Gjate vitit 2021, gjithsej jane kryer 8 misione auditimi.

- Perputhshmeria me rregulloret ne lidhje me Aktivitet ne Mbulim te Rezerves Tenike dhe Matematike dhe Marzhi i Aftesise Pagueuse
- Demet e ndodhura te Sigurimit
- Debitoret dhe llogarite e arketueshme (Ekspozimi)
- Raporti Financiar dhe Kontabiliteti
- Primet e Shkruara / ceduara ne risigurim
- Administrimin e policave te shitura ne qender dhe ne deget e INSIG JETE sh.a
- Sistemi i Teknologjise dhe informacionit
- Çeshtjet e parandalimit dhe pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit, etj

Raportet e auditimit jane hartuar ne perputhje me Manualin e Auditimit te Brendshem, si persa i perket formatit raportues (struktures se raporteve te auditimit) ashtu edhe persa i perket permbajtjes. Ne fund te çdo raporti jane lene rekomandimet e dhena nga auditimi, te cilat jane pranuar nga Menaxhimi.

- **Analiza e misioneve te Auditimit**

Gjate vitit 2021 misionet e auditimit jane kryer ne Insig Jete sha, ku Shoqeria ushtron aktivitetin e saj kryesor. Ne disa prej misioneve te realizuara jane konstatuar elemente per tu permiresuar dhe per secilen prej tyre jane dhene rekomandimet perkatese, te cilat jane pranuar nga Menaxhimi.

Auditimet gjate vitit 2021 jane kryer te plota ne fushat si me poshte:

Sitemi i marrjes ne sigurim dhe risigurim per produktet e jetes, jane ushtruar kontrolle ne lidhje me praktiket e marrjes ne sigurim, plotesimi i dokumentacionit, zbatimin e udhezimeve te marrjes ne sigurim dhe risigurim. Llogaritja e shpenzimeve te marrjes ne sigurim per cdo produkt. Tarifimi dhe administrimi i produkteve te sigurimit te jetes. Kriteret e mbajtjes se kompanise per limitin e rrezikut ne risigurim, rrisqet bazuar ne llojin e produktit. Kontratat e bashkesigurimit, traty, facultative per produktin e jetes debitorit si dhe vleresimi i rrezikut per produktin e jetes ne grup me AP. Te gjitha produktet e jetes leshohen nga agjente te licensuar dhe stafi.

Sistemi i vleresimit dhe trajtimi te praktikave te demeve te ndodhura,

Jane ushtruar kontrolle ne lidhje me trajtimin e ngjarjeve te sigurimit ne zbatimim te ligjshmesrise dhe plotesimit te dosjeve te demeve. Te gjitha dosjet e demeve permbajne

informacionin dhe dokumentacionin e nevojshem per pagese. Ne te gjitha rastet e audituara demet perbejne ngjarje sigurimi. Vlera e pageses se demeve eshte e njejte me vleren e miratuar nga komisioni i trajtimit dhe vleresimit te praktikave. Gjithashtu, perditesimi i bazes se te dhenave ne rregjistrimin e demeve kryhet ne menyre kronologjike dhe te rregullt, per demet e paguara, dhe ato ne rezerve . Te gjitha demet raportohen prane Autoriteti te Mbikeqyrjes Financiare , rregjistrohen ne formatin elektronik dhe raportohen sipas kerkesave te AMF (deme te ndodhura te paguara dhe ne proces).

Evidentimi I debitoreve dhe analiza sipas produkteve per arketimin e tyre ne kohe,

Ne evidentimin e detyrimeve debitore dhe analizen sipas produkteve, konstatojme se kryhet ne menyre periodike ndjekja dhe arketimi i primit sipas percaktimeve ne kontrate.

Veprimtaria Financiare,

Konstatojme se ne Departamentin e Finances, jane rregjistruar te gjitha veprimet ne llogarite perkatese dhe kjo ben qe pasqyrat financiare te pasqyrojne nje realitet te sakte te veprimtarise Kompanise. Te gjitha pagesat jane kryer mbeshtetur ne dokumentacionin shoqerues te nenshkruar nga personat perkates dhe Drejtore Ekzekutive. Insig Jete sha ka deklaruar dhe paguar te gjitha detyrimet ligjore.

Veprimtaria e TI ne Insig Jete sha,

Veprimtaria e teknologjisë se Informacionit dhe Siguria e Informacionit , eshte rregulluar me Rregulloren “ Per Politiken e Sigurise se Informacionit ne INSIG Jete sha” miratuar me vendim te K.M.Monitorimi dhe kontrolli i te gjitha operacioneve qe kryen TI, realizohet nepermjet telefonise, email-it. Insig-Jete e ka te mbeshtetur infrastrukturen e vete te Network-ut mbi ate te Eurosig Sh.a. Eshte ristrukturuar network ne Drejtorine Qendrore te Insig Jete sha si dhe jane vendosur pajisje profesionale per menaxhimin e tij. Jane ndertuar servera te dedikuar ne sherbim te Insig Jete sha. Eshte bere perditesimi i sistemit me zhvillimet e fundit qe edusoft zoteron per moduln e jetes,Eshte realizuar ne masen 90% sistemi i fiskalizimit (automatik dhe manual).

Mjaftushmeria e kapitalit, aktivet ne mbulim te provigjoneve.

Provigjonet teknike janë perllogaritur dhe raportuar periodikisht cdo fund tre mujori dhe fund viti nga Aktuari i Kompanise i cili depoziton prane Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare Raportin Aktuarial mbi Provigjonet Teknike dhe Matematike.

Rezervat e perllogaritura nga aktuari mbahen ne formatin excel sipas produkteve dhe ne vlere sipas monedhave mbeshtetur ne databazet e derguara nga Departamentet Perkatese .

Konstatojme se aktuari i ka llogaritur provigjonet teknike dhe matematike ne perputhje me Rregulloren Nr.187 date 24.11.2016 te AMF si dhe standartet aktuaristike.

INSIG Jete sha zoteron aftesine paguese sipas kerkesave te nenit 80, pika 1 e ligjit 52/14 “Per veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit” dhe se treguesi i aktiveve ne mbulim te PT jane mbi nivelin e kerkuar. Nga pikepamja cilesore kapitali i Shoqersise eshte i lire dhe INSIG Jete sha zoteron aftesine paguese sipas kerkesave te nenit 80, pika 1 e ligjit 52/14 “Per veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit” dhe se treguesi i aktiveve ne mbulim te PT jane mbi nivelin e kerkuar.

Çeshtjet e parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,

Ne lidhje me këte Inspektim janë vlerësuar të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe procedurat e brendshme dhe masat e mara në zbatimin të ushtrimit të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar në lidhje me “Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. Është bërë kryqezimi i të dhënave të policave të shitura nga sistemi me listën PEP si dhe listën në lidhje me Terrorizmin si dhe cdo dokumentacion tjetër që disponohet nga Kompania. Konstatohet se janë hartuar dhe zbatuar programe trajnimi për punonjësit. Për të gjithë personat PEP disponohet dokumentacioni i plotë sipas ligjit në fuqi. Gjate vitit 2021, nuk ka patur transaksione apo raste të analizuar nga Shoqëria INSIG Jete sh.a që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë, për pastrim parash apo financim të terrorizmit brenda ose jashtë vendit.

- **Plani i auditimit për vitin 2022**

Objektivat e planit të auditimit për vitin 2022 do të arrihen nepermjet harmonizimit dhe kontrolleve të thelluara dhe tematike, duke kryer vlerësimin e rreziqeve në kohë dhe me efektivitet. Në përcaktimin e rrisqeve, me të cilat do të haset shoqëria gjate vitit 2022, do të bazohemi kryesisht në rrisqet e hasur gjate vitit 2021 si dhe në rekomandimet e dhëna nga organet rregullatore dhe auditimi i jashtëm.

Gjate vitit 2022, fushat që do të auditohen do të jenë ato prioritare dhe ato me rrezik të lartë.

Objekte dhe fusha për tu audituar në vitin 2022

- Gjithsej do të kryhen 9 auditime të ndara sipas fushave me poshte:
- Menaxhimi i Riskut, dizenjimi dhe efektiviteti i kontrollit të brendshëm
- Përputhshmëria me Rregulloret, Aktivitet në Mbulim të PT dhe Marzhi i Aftësisë Paguese.
- Debitoret dhe Llogaritë e Arketueshme (Ekspozimi i tyre)
- Demet e ndodhura të sigurimit.
- Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti.
- Primet e shkruara / ceduara në risigurim.
- Sistemi i Teknologjisë Informacionit.
- Misionet e ndryshme verifikimi në Qendër dhe degë të INSIG Jete sh.a.
- Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve të kryera gjate vitit 2021.

Duke u mbështetur në nivelin e riskut, janë evidentuar sistemet me të rëndësishme të auditimit në INSIG JETE sh.a. të klasifikuara sipas nivelit të riskut, Fusha auditimi që konsiderohen me rrezik të lartë :

- Menaxhimi i Riskut, Baza rregullative e Shoqërisë në të cilën mbështetet funksionimi i veprimtarisë INSIG Jete sh.a;
- Demet e ndodhura të sigurimit
- Debitoret dhe llogaritë e arketueshme (Ekspozimi)

Fusha auditimi te konsideruara me risk te mesem jane vleresuar :

- Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti
- Sistemi i Teknologjise Informacionit
- Primet e shkruara / ceduara ne risigurim

- **Pohimi i pavaresise**

Auditimi i brendshem eshte kryer sipas kuadrit ligjor dhe rregullator . Audituesi i brendshem respekton rregullat e etikes dhe te sjelljes.Mban qendrim te paanshem dhe i shmanget konfliktit te ineresit. Ka funksionuar si njesi e pavarur. Referuar nje programi metodologjik, kronologjk, gjithepershires, adekuat, dhe ka raportuar me shkrim dhe efektivitet punen e kryer pa u ndikuar.

- **Opinion i Njesise Auditimit te brendshem**

Njesia e Auditimit te Brendshem ka realizuar detyrat e planifikuara bazuar ne planin e auditimit te brendshem, te miratuar nga Keshilli i Administrimit per vitin 2021.

Gjate punes se kryer per cdo kontroll te ushtruar, jane nxjerre konkluzionet perkatese dhe atje ku jane konstatuar elemente per t'u permiresuar, jane dhene rekomandimet perkatese.

Njesia e Auditimit te Brendshem

Adriana KUCI

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 dhjetor 2021

	Shënim e	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
		në Lekë	në Lekë
AKTIVET			
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	9	8,365,176	6,972,021
Depozita me afat	10.1	539,655,854	544,498,838
Letra me vlerë të qeverisë	10.2	0	0
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi e risigurimi, neto	10	36,087,701	23,500,607
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11.1	1,075,446	1,730,252
Shpenzime të marrjes në sigurim, të shtyra	12	38,165,253	30,380,077
Aktive të risigurimit	13	11,321,904	13,120,615
Aktive të tjera	14	757,553	493,620
Tatime të parapaguara	15	888,334	1,246,775
Aktive të shtyra tatimore	15	17,882	48,499
E drejta e shfrytëzimit të qirase IFRS 16	16.1	1,602,119	6,404,985
Aktivitet afatgjatë jomateriale	17	2,850,534	2,515,047
Toka e mbajtur për investim	18	447,932,748	437,969,486
Aktivitet afatgjatë materiale	16	7,104,216	7,764,398
SHUMA E AKTIVEVE		1,095,824,720	1,076,645,220
DETYRIMET			
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	20	9,759,728	7,958,759
Detyrime të tjera	19	15,848,347	13,929,352
Detyrime për tatim fitimin	32	0	120,279
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen	22	76,056,123	71,818,718
Rezerva për primin e pafituar	23	125,706,074	116,058,779
Detyrimi ndaj qiramarrësve IFRS 16	16.1	1,686,993	6,739,026
Detyrime ndaj institucioneve financiare	21	169,199,879	182,662,754
Qira Financiare	21	0	0
SHUMA E DETYRIMEVE		398,257,144	399,287,667
KAPITALI			
Kapitali themeltar i paguar	24	590,000,000	590,000,000
Tepricë Rivleresimi		3,297,097	3,297,097
Fitime të pashpërndara		104,270,479	84,060,456
SHUMA E KAPITALIT		697,567,576	677,357,553
SHUMA E DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,095,824,720	1,076,645,220

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE

për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2021

	Shëni me	Periudha 1 janar 2021 deri me 31 dhjetor 2021 në Lekë	Periudha 1 janar 2020 deri me 31 dhjetor 2020 në Lekë
Prime të shkruara bruto	25	218,196,787	199,816,141
Prime të shkruara çeduar risiguruesit	26	-19,738,103	-20,402,637
Prime të shkruara neto		198,458,684	179,413,504
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	23	-9,647,296	74,103
Ndryshimi neto në rezerva të tjera	22	-4,237,405	-7,063,789
Ndryshimi neto në rezervën e risiguruesit	13	-1,798,711	4,479,374
Ndryshimi neto në shpenzime të shtyra	12	7,785,176	5,486,932
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		190,560,448	182,390,124
Të ardhura nga investimet	27	10,299,488	10,272,797
Shpenzime financiare	27	-229,742	-501,937
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	27	2,557,961	713,450
Të ardhura të tjera operative	31	5,778,263	4,774,865
Totali i të ardhurave të tjera		18,405,970	15,259,175
Dëme të ndodhura të sigurimit	22.1	-88,239,914	-55,603,496
Dëme të paguara nga risiguruesi	22.1	25,468,567	0
Kostot e marrjes në sigurim	28	-69,175,341	-54,231,780
Shpenzime personeli	29	-30,674,855	-32,452,783
Shpenzime administrative	30	-15,938,152	-21,348,433
Amortizimi	16_16.1	-6,542,359	-7,046,935
Totali i shpenzimeve		-185,102,054	-170,683,427
Fitimi para tatimit		23,864,364	26,965,872
Tatimi mbi fitimin	32	-3,654,342	-4,609,158
Fitimi i periudhes		20,210,022	22,356,714
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		0	3,297,097
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën		20,210,022	25,653,811

PASQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL

	Kapitali themelar në Lekë	Rezerva rivleresimi në Lekë	Fitime të pashpërndara në Lekë	Totali në Lekë
Gjendja më 01 Janar 2020	370,000,000		59,387,954	429,387,954
Fitimi i periudhes				-
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	3,297,097	24,672,502	27,969,599
Rritje në kapitalin e paguar	220,000,000	-	-	220,000,000
Dividenti i paguar	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	590,000,000	3,297,097	84,060,456	677,357,553
Fitimi i periudhes	-	-	-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	20,210,023	20,210,023
Rimarrje e rezervës së rivlerësimit			-	-
Rezerva nga rivleresimi I asetëve			-	-
Rritje në kapitalin e paguar	-	-	-	-
Dividenti i paguar	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	590,000,000	3,297,097	104,270,479	697,567,576

KAPITALI AKSIONAR

Me vendimit 117 të Bordit, datë 31/08/2020, Autoriteti I Mbikqyrjes Fiananciare vendosi miratimin e pjesëmarrjes influencuese në masën:

- 100% të aksionari Shoqëria jo - jetë "EUROSIG" sh.a. në shoqërinë e sigurimit të Jetës "Insig Jetë" sh.a..

Struktura e kapitalit paraqitet si mëposhte:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shoqëria e sigurimit jo-jete Eurosig sha	100%	100%
TOTALI	100%	100%

Aksionari I vetem Eurosig sha me ane te vendimit nr 10 dhe 11 date 23 dhjetor 2020 ka aprovuar raportin e ekspertit kontabel per rritjen e kapitalit aksionar ne natyre me pasuri te paluajtshme truall si dhe aprovon rndryshimet qe vijne si pasoje e rritjes se kapitalit aksionar nga 370.000.000 Leke ne 590.000.000 Leke. Kontributi eshte shlyer ne natyre me toke truall, me sipërfaqe 5.443.7 m2 e ndodhur ne Tirane me nje vlere tregu 220,00,000 Leke. Aprovimi I rritjes se kapitalit nga AMF eshte bere me ane te vendimit nr 58 date 26.03.2021.

Kapitali themeltar I shoqerise me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 i cili zoterohet nga aksionaret e shoqerise:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Numri I aksioneve	616,000	616,000
Vlera nominale	957.79	957.79
	590,000,000	590,000,000

Kapitali themeltar i shoqerise me 31 dhjetor 2021 ne vleren 590,000,000 Leke perbehet nga:

- 370,000,000 Leke kapital themltar I paguar
- 220,000,000 Leke kapital kontribut ne natyre pasuri e paluajtshme - truall

Kapital themeltar, eshte ne perputhje me nenin 17, dhe nenin 98 te ligjit Nr.9267, datë 29.7.2004 "Per veprimtarine e sigurimit, te risigurimit dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime" i cili kerkon qe shoqeria duhet te kete kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, jo më të vogël se vlerat e përcaktuara të fondit të garancisë, të parashikuara në nenin 98 të këtij ligji.

PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË
për periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2021

	<u>01.01.2021</u>	<u>01.01.2020</u>
	<u>-31 .12.2021</u>	<u>-31 .12.2020</u>
Fluksi i parasë nga aktivitete operative		
<i>(Humbja)/Fitimi para tatimit</i>	23,864,364	26,965,872
Rregullime për:	-	-
Amortizimin	6,542,359	7,046,935
Fitim/ humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e AQT	-	2,668,673
Ndryshimi në rezervën e primet e pafituara	9,647,296	(74,105)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit	1,798,711	(4,479,374)
Ndryshimi në neto në rezerva të tjera	4,237,405	7,063,789
Ndryshim ne aktiv te shtyre tatimor	30,617	-
Zhvlerësim për borxhin e keq	77,045	233,681
Humbje nga kursi i këmbimit	(2,557,961)	(3,426,651)
Shpenzime per interesin	229,742	501,937
Të ardhura nga interesi	(10,299,488)	(10,272,797)
Fluksi i parasë përpara ndryshimeve në aktive dhe detyrime	33,570,090	26,227,960
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:		
Ndryshime në shpenzime të marrjes ne sigurim, te shtyra	(7,785,176)	(5,486,933)
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe risigurimit	(13,208,560)	(6,695,313)
Ndryshimi në aktivet e tjera	(263,933)	956,097
Ndryshime ne tatime te parapaguara	217,390	857,104
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe risigurimit	2,068,001	13,059,188
Ndryshimi në detyrime ndaj qirase	(5,497,146)	(6,126,414)
Ndryshimi në detyrime të tjera	2,046,238	(3,992,982)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme me palët e lidhura	655,312	14,894,973
Interesi i arkëtuar	5,713,772	9,348,975
Interes i paguar	(5,787,352)	(15,193)
Tatim fitim I paguar	(3,633,569)	(1,634,895)
Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet	(25,475,023)	15,164,607
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve jomateriale	(945,459)	(489,925)
Blerja e aktiveve të trupezuara	(469,338)	(225,663)
Te ardhura nga shitja e aseteve	-	2,630,000
Ndryshim ne aktive te mbajtura per investim	(4,175,910)	(433,267,466)
Ndryshimi ne depozita me afat	8,498,534	(200,698,185)
Letra me vlere te maturuara	-	187,680,006
Blerje letre me vlere	-	-
Ndryshimi ne detyrime ndaj institucioneve financiare	(9,254,750)	182,662,754
Flukset monetare për aktivitetet investuese	(6,346,923)	(261,708,479)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Emetimi i kapitalit	-	220,000,000
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese	-	220,000,000
Rritje/(Rënie) neto për mjetet monetare dhe ekuivalente	1,748,144	(315,912)
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	6,972,027	7,036,696
Efekti i ndryshimit te kursit te kembimit	(354,995)	251,237
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit	8,365,176	6,972,021

ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË SIGURIMIT

Objektivi kryesor i strukturës së administrimit të rrezikut dhe financiare të Shoqerise është për të mbrojtur aksionarët e Shoqerise nga ngjarjet që pengojnë arritjen e qëndrueshëm të objektivave të performancës financiare, duke përfshirë dështimin për të shfrytëzuar mundësitë. Drejtimi njih rëndësinë kritike për të pasur sisteme efikase dhe efektive të administrimit të rrezikut.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervë paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përlogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të politikave, anulimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve.

Shoqeria ka krijuar një politike dhe funksion të administrimit të rrezikut me terma të qarta referimi nga Këshilli i Administrimit të Shoqerise. Objekti i kesaj rregulloreje eshte percaktimi i parimeve baze mbi te cilat Shoqeria nderton sistemin e administrimit te rrezikut si dhe i procedurave dhe politikave per identifikimin, matjen dhe kontrollin e rreziqeve te Shoqerise. Kjo rregullore eshte hartuar ne baze dhe per zbatim te Ligjit Nr.52, date 22.05.2014, “Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit”, neni 27 dhe Rregullores Nr.5 date 05.11.2019 “Per rregullat e organizimit te sistemit te administrimit te rrezikut ne shoqerine e sigurimit”.

Provizioni bëhet në datën e raportimit për kostot përfundimtare të pritshme të shlyerjes për të gjitha dëmet e ndodhura në lidhje me ngjarje deri në atë datë, pavarësisht nëse janë të raportuara apo jo, bashkë me shpenzimet e administrimit të dëmeve, minus shumat e paguara.

Detyrimi për dëmet e raportuara por jo të paguara (RBNS) vlerësohet si i ndarë rast pas rasti duke i dhënë rëndësinë e duhur shkaqeve të dëmit, informacionit të marrë nga vlerësuesit e humbjes dhe nga të dhënat historike të përmasave të dëmeve të ngjashme. Rezervat e rasteve rishqyrtohen rregullisht dhe përditësohen kur ka informacion të ri.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por të pa-raportuara (IBNR) është përgjithësisht subjekt i një shkalle më të lartë pasigurie sesa për dëmet të raportuara. Provizionet e IBNR janë kryesisht të vlerësuara nga aktuarët e Shoqërisë duke përdorur teknika statistikore, përmes të cilave të dhënat historike përdoren në mënyrë që të bëhet një vlerësim i kostove përfundimtare të dëmeve.

Për kontratat e sigurimit të jetës, vlerësimet bëhen si për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të raportuara në deklaratën e datës së gjendjes financiare dhe për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të ndodhura por jo të raportuara ende në Deklaratën e datës së

pozicionit financiar ("IBNR"). Kostoja përfundimtare e kërkesave të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të kërkesave të teknikave standarde të projektimit.

Supozimi kryesor në themel për këto teknika është se për një kompani pretendimet e kaluara si përvojë zhvillimi mund të përdoren për projektin e zhvillimit të kërkesave të ardhshme dhe kostot përfundimtare. Si të tilla, këto metoda nxjerrin zhvillimin e paguar dhe humbjet e shkaktuara, shpenzimet mesatare për kërkesë dhe numrat e kërkesave të bazuar në zhvillimin e vërejtur vitet e mëparshme dhe raportet për humbje që priten.

Për llogaritjen e IBNR-se për produktet e sigurimit të Jetes në kushtet e numrit të ulet të dëmeve në çdo portofol, është i pamundur përdorimi i metodës së trekëndeshave, për këtë arsye në llogaritjen e saj është marrë në konsideratë Raporti i Humbjeve për të paktën 3 vitet e fundit të aktivitetit mbi Primin e fituar të periudhës respektive dhe me një vlerë të maksimizuar të raporteve dhe është vlerësuar raporti i mundshëm i humbjeve të periudhës duke përcaktuar kështu Ultimate Reserve për çdo portofol.

Është bërë analiza e raportit IBNR faktike për çdo një vit nga periudha në analizë dhe ky është optimizuar dhe aplikuar mbi Ultimate reserve për çdo produkt duke përcaktuar kështu nivelin e IBNR. Nderkohe që analiza e testeve run-off, ka rezultuar pozitive për të tërë produktet.

Nderkohe që në portofolin e sigurimit të jetes së Debitorit, ku të dhënat në vite dhe numri I dëmeve na e lejojnë, është aplikuar metoda klasike e IBNR me anë të trekëndeshit të zhvillimit të dëmeve.

Supozimet të cilat kanë efektin më të madh në matjen e detyrimit për sigurimin e jetës janë si më poshtë:

Norma e dëmeve të pritshme

Normat e dëmeve të pritshme është norma e dëmeve të pritshme për të ndodhur ndaj primeve të fituara. Supozimet në lidhje me normat e dëmeve të pritshme për vitet më të fundit të aksidenteve, sipas produktit, kanë ndikimin më të madh në nivelin e provigjioneve.

Distanca kohore

Për produktet me distancë kohore midis ndodhjes së dëmeve, niveli i provigjioneve influencohet shumë nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve nga viti më i fundit i zhvillimit për të cilin të dhënat historike janë të vlefshme deri në shlyerjen më të fundit. Këta faktorë vlerësohen me kujdes bazuar në eksperiencë.

a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe pasiguria për shumën e dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i zakonshëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit ku ajo supozon rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrveshjeve për humbjen.

Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e probabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lind sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

b) Strategjia e marrjes në sigurim

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur lëvizshmërinë e rezultateve të pritshme.

c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshte.

Natyra e rrezikut të mbuluar

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë të tilla si paaftësitë e perkohshme ose të përhershme, mbulimin e shpenzimeve mjekësore, shpenzimet spitalore dhe të riaftësimin. Te tera produktet e kompanise paraqesin karakteristika te produkteve afatshkurter, te rinovueshme cdo vit, duke perfshire opsionin e rregullimit te cmimit dhe asnjera nuk permban element kursimi apo vlere te kthyeshme.

Jeta e debitorit mbulon riskun e vdekjes natyrore apo aksidentale brenda nje afati te percaktuar ne police i cili zakonisht perfshin nje periudhe afatshkurter. Keto polica nuk mbulojne shpenzime te natyrave te tjera pervec ketij risku.

Policat e sigurimit të shëndetit ofrojnë mbulime të humbjes së jetes si dhe paaftësitë e përhershme apo të perkohshme, duke perfshire ketu dhe mbulim te shpenzimeve me natyre spitalore apo jashte spitalore. Periudha e mbulimit eshte afatshkurter, zakonisht 1-vjecare, por ofrohet dhe per periudha me te shkurtra nese personi eshte ne udhetim.

Policat e tjera te ofruara nga kompania kane afat 1-vjecar dhe mbulojne riskun e humbjes natyrore te jetes te shoqeruar me perfitime paaftesise ose spitalore gjate ndodhjes se nje aksidenti.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruksi kryesor. Nëse risiguruksi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin.

Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin ndaj humbjeve dhe për të minimizuar efektin e humbjeve nga sigurimi i jetës për kreditë nëpërmjet marrveshjes risiguruese “Marreveshje mbi bazen e rrezikut” (Treaty on Risk Premium Basis”) me mbulim deri në shumën 100,000 Euro.

Për produktet e tjera, të cilat kanë shumën e uletës së sigurimit nuk ka marrveshje në fuqi. Në rastet e risqeve specifike Shoqëria ka kontratë risigurimi të tipit “excess of loss” bazuar në akumulimin e riskut dhe ashpersinës e ngjarjes.

Tabela e mëposhtme paraqet mbulimin maksimal agregat për kontratat e sigurimit të jetës së kredimarrësve sipas moshës për 31 dhjetorin 2021. Analiza e ekspozimit kontraktual konsiderohet si treguesi më i mirë për përqëndrimin e rrezikut të sigurimit.

Moshë për sigurimin e jetës së kredimarrësve	31 dhjetor 2021	
	Në lekë	Në %
Deri 29	2,636,877,919	9.25%
30 – 39	11,726,693,252	41.11%
40 – 49	8,229,971,105	28.85%
50 – 59	5,222,972,286	18.31%
Mbi 60	705,548,080	2.47%
Totali	28,522,062,642	100%

d) Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Gjatë aktivitetit të saj të sigurimit shoqëria akumuluar ekspozim të rëndësishëm që lidhet me ngjarjen e pandemisë Covid 19. Produkti i jetës së debitorit është produkti i ekspozuar ndaj kësaj ngjarjeje. Duke marrë në konsideratë që numri i policave tona në fuqi, të cilat e mbulojnë këtë risk është 9252 polica në fuqi më datë 31 Dhjetor 2021. Gjatë vitit 2021 janë raportuar 7 dëme të humbjes së jetës nga Covid 19, ku totali i raportimeve për këtë produkt ishte 18 në total, ekspozimi ynë për dëme të pritshme në këtë portofol (total humbje jete përfshirë edhe Covid 19) është rreth 45 polica, ndërkohë që me vaksinimin e popullsisë duket se severitë e rasteve është ulur ndjeshëm.

MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Transaksionet me instrumentet financiare rezultojnë për Shoqërinë që të llogarisë rrezikun financiar. Këto përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Shoqëria i menaxhon këto rreziqe.

a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh:

- Rreziku valutor – rreziku që vlera e instrumentave financiarë do të variojë nga ndryshimet në kurset e këmbimit.
- Rreziku i normës së interesit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë nga ndryshimet në treg të normës së interesit.
- Rreziku i çmimit – rreziku që vlera e instrumentave financiare do të variojë si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, qofshin këto ndryshime si rezultat i faktorëve specifik të instrumentit financiar ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentet financiare që janë në treg.
- Rreziku i tregut nuk përfshin vetëm mundësinë për të humbur, por edhe mundësinë për të fituar.

Përputhja aktive/detyrim

Shoqëria i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksionar.

Shoqëria vendos objektiva për portofol aktivesh për çdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brënda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqëndrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasi të përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të arritur objektivat e menaxhimit të asetëve/detyrimeve. Shoqëria ka ndërmarrë disa transaksione në monedhë të huaj. Kështu që, ekspozimi ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit rritet.

Shoqëria gjatë vitit ushtrimor ka marrë masa për të ulur ekspozimin e rrezikut valutor duke u perpjekur që të përputhe sa më përafërsisht aktivet financiare të Shoqërisë me detyrimet e sigurimit dhe kontratat e investimeve sipas monedhave.

AKTIVET NË MBULIMIN E PROVIGJIONEVE TEKNIKE

Në përputhje me Rregulloren për aktivet në mbulim të provigjoneve matematike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve miratuara me vendimin e bordit nr. 200, datë 27 dhjetor 2016, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë jo më shumë se normat e mëposhtme të aktiveve dhe investimeve për të mbuluar rezervën teknike dhe matematike:

			128.11%
31 dhjetor 2021	Kufiri i investimeve në raport me provigjionet	Kufiri i investimit në vlerë sipas rregullores	Aktivitet në mbulimin e provigjoneve teknike
Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara	3.50%	7,061,677	2,795,934.80
Toka dhe Ndertesa	30%	60,528,659	29,119,989.00
Aksione dhe investime në tregun e parasë	5%	10,088,110	
Sig. të arkëtueshme (% mbi rez.e primit të pafitur)	20%	25,141,215	23,953,667.00
Aktivitet e risigurimit	100%	201,762,197	11,321,904.00
Hua të pasiguruara	5%	10,088,110	
Mjete monetare në arkë dhe llog.rrjedhëse	3%	6,052,866	6,052,865.91
Letra me vlerë të qeverisë (Bono Thesari)	70%	141,233,538	-
Hua të hipotekuara	15%	30,264,330	
Depozita me afat	100%	201,762,197	161,252,720.00
Shpenzime te shtyra te marrjes ne sigurm	15%	18,428,402	18,428,402.10
Parapagime dhe të ardhura të llogaritura	5%	10,088,110	5,559,854.00
			258,485,337

LLOGARITJA E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Në përputhje me Nenet 75-80 të Ligjit Nr 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” Shoqëria e Sigurimit llogarit mjaftueshmërinë e kapitalit që përbën dhe aftësinë paguese të saj. Aftësia paguese përbëhet nga aktivet e shoqërisë së sigurimit të lira nga çdo përgjegjësi e parashikueshme, duke zbritur prej tyre elementët e zbritshëm sipas Rregullores së Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare nr. 87 datë 27 qershor 2016.

Aftësia paguese më 31 dhjetor 2021 është si më poshtë:



LLOGARITJA E MJAFTUESHMËRISE SË KAPITALIT

	31 dhjetor 2021
A: Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit)	697,567,576
B: Elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit sipas nenit 79 të ligjit 52/2014	243,203,301
-Aktive te ndryshme nga Toka dhe Ndertesa	66,531
-Toka dhe ndertesa	223,230,728
-Aktive te patrupezuara	2,850,534
- Gjendja e inventarit	757,553
- Garanci per kontrata sigurimi	-
- Debitorë policembajtës mbi 90 ditë	11,473,013
- Llogari te arktueshme nga palet e lidhura	1,075,446
-Tatime te parapaguara	888,334
-Aktiv I shtyre tatimor	17,882
-Depozita te lena si kolateral	2,843,280
- Te tjera te arketueshme	
C: Kapitali Aftesia paguese A-B	454,364,275
D: Kufiri minimal i aftësisë paguese sipas pikës 3 të nenit 80 të ligjit 52/2014	103,564,978
E: Fondi i Garancisë sipas nenit 81 të ligjit 52/2014	370,000,000
F: Niveli i kërkuar i aftësisë paguese sipas pikës 2 të nenit 80 të ligjit 52/2014	370,000,000
Mbi (+) nën (-) nivelin e kërkuar të aftësisë paguese (C-F)	84,364,275
Mjaftueshmëria e kapitalit	84,364,275

MARZHI i AFTËSISË PAGUESE

Niveli i kërkuar i Aftësisë Pagueuse të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370 milione Lekë) dhe 4.2 here të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2021 është brenda limiteve të kërkuara.

		31 dhjetor 2021
a) Niveli i kërkuar i aftësisë paguese bazuar në produktet e sigurimit të jetës, ndryshe nga fondet e investimeve		
<i>Llogaritja e parë</i>		
a) Shuma e rezervave matematike për veprimtaritë e veta dhe ato të marra në risigurim, pa zbritur rezervat që i perkasin pjesës së dhënë në risigurim	(a)	201,762,198
b) Shuma e rezervave matematike për veprimtaritë e veta dhe ato të marra në risigurim, pasi zbriten rezervat që i perkasin pjesës së dhënë në risigurim	(b)	190,440,293
c=b/ a	(c)	0.944
d= koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e përfitimit nga investimet I cili është vlera maksimale e diferencës midis llogaritjeve dhe përfitimit aktual në investime kjo vlerë është e barabartë me 0.04	(d)	0.04
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese bazuar në llogaritjen e parë (a*c*d)		7,617,612
<i>Llogaritja e dytë</i>		
Kapitali bruto në rrezik për kontratat mbi 5 vjet	(a1)	26,173,734,687
Kapitali neto në rrezik për kontratat mbi 5 vjet	(b1)	1,170,329,947
Kapitali bruto në rrezik për kontratat ndërmjet 3-5 vjet	(a2)	26,340,058,873
Kapitali neto në rrezik për kontratat ndërmjet 3-5 vjet	(b2)	23,379,749,518
Kapitali bruto në rrezik për kontratat deri në 3 vjet	(a3)	116,694,057
Kapitali neto në rrezik për kontratat deri në 3 vjet	(b3)	24,815,382,275
Koeficienti i risigurimit	(c)	0.94
Koeficienti i pasigurisë	(d1)	0.003
Koeficienti i pasigurisë	(d2)	0.0015
Koeficienti i pasigurisë	(d3)	0.001
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese bazuar në llogaritjen e dytë (a1*c*d1)+(a2*c*d2)+(a3*c*d3)		110,818,466
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese		118,436,078
b) Niveli i kërkuar i aftësisë për produktet e sigurimit të jo-jetës që lidhen me aktivitetin e sigurimit të jetës		
Primi i sigurimit	(a)	70,663,401.00
Primet e sigurimit të cilat nuk kalojnë 1,000,000,000 Lekë	(a1)	1,579,818.00
Primet e sigurimit të cilat kalojnë 1,000,000,000 Lekë	(a2)	23,704,147.00
Koeficienti i risigurimit	(c)	-
Koeficienti i pasigurisë për primet deri në limitin a1	(b1)	0.18
Koeficienti i pasigurisë për primet që kalojnë limitin a1	(b2)	0.16
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese (a1*b1*c)+(a2*b2*c)		
Totali i nivelit të kërkuar të aftësisë paguese		118,436,078

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Insig Jete sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Insig Jete sh.a (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera janë të gjitha informacionet e dhëna në raportin vjetor, përveç pasqyrave financiare, raportit të drejtimit dhe raportit të auditimit.

mazars

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

29 prill 2022


mazars
Emin Duraku Shtet, Binjaket Bulld.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIIS: K32123006W

Teit Gjini
Auditues Ligjor